



Termet dhe Kushtet e Shërbimit të Vodafone TV

Këto terma dhe kushte rregullojnë përdorimin nga ana juaj (1) Pajtimtarit, emri i të cilit shfaqet në formularin e regjistrimit të klientit dhe në Kontraten e Pajtitimit (“ju”, “klienti” ose “pajtimtari”) dhe (2) Vodafone Albania (“ne”, “neve” ose “jonë”) në lidhje me Shërbimin Vodafone TV (“Shërbimi”).

Këto terma dhe kushte specifike të shërbimit zbatohen si shtesë dhe janë pjesë e Termave dhe Kushteve të Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimit të Komunikimeve Elektronike dhe Audiovizive, dhe çdo kusht shërbimi shtesë në të cilin jeni pajtuar/abonuar. Për të shmangur dyshimet, kushtet e mëposhtme do të jenë pjesë dhe do të zbatohen bashkë me termat dhe kushtet e Kontratës së Pajtitimit që keni nënshkruar me Vodafone Albania Sh.A. Në rast të ndonjë konflikti midis kushteve, rendi i përparësisë do të jetë si më poshtë: Kushtet Specifike të shërbimit Vodafone TV të përcaktuara më poshtë së pari, të ndjekur nga çdo term dhe kusht specifik i shërbimit të Komunikimeve Elektronike dhe Audiovizive, si dhe Kushtet e Përgjithshme të Shërbimeve të Internetit Fiks.

Ju lutemi lexoni me kujdes këto Kushte të Vodafone TV dhe kini parasysh se fjalët me shkronja të mëdha kanë kuptime të veçanta - shihni seksionin 'Përkufizimet' në fillim të këtyre kushteve. Ju pranoni të jeni të detyruar të zbatoni Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Ofrimit të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike dhe Audiovizive, çdo term dhe kusht specifik të shërbimit të internetit fiks, si dhe këto kushte specifike të shërbimit televiziv ndërkohë që merrni Shërbimet Vodafone TV, dhe pajtoheni me këtë Marrëveshje, të cilën gjithashtu mund ta gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.vodafone.al/informacion-ligjor/kushte-dhe-afate/kushte-dhe-afate/>.

Ju pranoni që jeni përgjegjës për respektimin e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht kush e përdor Shërbimin Vodafone TV në familjen tuaj ose që ka akses në Shërbimin Vodafone TV të lidhur me llogarinë tuaj.

1. Përkufizimet

Fjalët në vijim do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Përmbajtja audiovizive – si p.sh. programe dhe filma televizivë, aplikacione, informacione dhe/ose shërbime të tjera të aksesueshme nëpërmjet Shërbimit Vodafone TV nëpërmjet [Vodafone TV Box dhe/ose aplikacionit Vodafone TV] në televizorin ose pajisjen tuaj celulare.

Plani Tarifor - shuma minimale mujore që ju faturojmë për paketën e Shërbimeve TV Vodafone që keni zgjedhur.

Tarifat e shërbimit dhe mirëmbajtjes – tarifa që mund t'ju duhet të paguani për çdo mirëmbajtje të Shërbimit Vodafone TV, të cilën ne mund ta ndryshojmë herë pas here, siç përcaktohet në Planin tonë të Çmimeve të TV.

Autoriteti i Licencimit të TV - Autoriteti rregullator përgjegjës për ofrimin e shërbimeve audiovizive në Shqipëri, konkretisht Autoriteti i Mediave Audiovizive - (AMA).

Lista e Çmimeve të Shërbimeve Vodafone TV – lista e detajuar e Shërbimeve Vodafone TV të zbatueshme për ju si dhe çdo çmim të zbatueshëm për shërbime të tjera shtesë i cili është gjithashtu i disponueshëm në faqen tonë të internetit Vodafone TV | Vodafone.

Kanalet OTT - kanale me veçori ndërvepruese të tilla si rifillimi (catch-up), regjistrimi, rinisja, ndalimi i TV drejtpërdrejt.

Video sipas kërkesës (Video on Demand) – shërbim që u jep pajtimtarëve mundësinë të shikojnë programacion (filma seriale/tjetër) nga katalogu VOD në platformën Vodafone TV, i organizuar si një video bibliotekë personale.

Shërbimet e Internetit fiks – shërbimet e komunikimeve elektronike të internetit fiks që merrni nëpërmjet rrjetit tone kabllor.

Vodafone TV Box – nënkupton pajisjen/et që ne ju ofrojmë si pjesë e Shërbimit Vodafone TV.

Aplikacioni Vodafone TV – aplikacioni celular ose tablet i përputhshëm me Apple iOS dhe Google Android i zhvilluar dhe në pronësi të Vodafone, i cili ju lejon të aksesoni dhe të përdorni Shërbimin Vodafone TV.

Pajisjet e Shërbimit Vodafone TV - dekoderi juaj i TV, karikuesi i dekodertit të TV që vendoset në një prize elektrike, telekomanda dhe të gjithë pajisjet e tjera ose kabllor/fisha që mundësojnë aksesimin e shërbimeve Vodafone TV.

Shërbimi Vodafone TV – shërbimet audio-vizive që Vodafone ju mundëson dhe nëpërmjet së cilave ju mund të aksesoni Përmbajtjen e disponueshme, sipas parashikimeve të këtyre Termave, që përfshijnë shërbimet dhe përmbajtjen TV, atë të Aplikacionit dhe shërbime të tjera.

2. Afati

2.1 Shërbimi Vodafone TV ofrohet për një kohëzgjatje me afat minimal siç përshkruhet dhe përzgjidhet nga Ju në Formularin përkatës të Regjistrimit (“Kontrata e Pajtitimit”). Pas përfundimit të Afatit Minimal dhe pas miratimit për vazhdimin e marrëdhënies kontraktore, kjo marrëdhënie kontraktore do të shndërrohet në një kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.



2.2 Secila palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje. Kjo mund të bëhet nga ju, Klienti, duke i dhënë Vodafone një njoftim paraprak me shkrim tridhjetë (30) ditë ose nga Vodafone duke i dhënë klientit një njoftim paraprak me shkrim tridhjetë (30) ditë. Kur ju e zgjidhni këtë Marrëveshje gjatë Afatit Minimal, do të aplikohet një penalitet siç përcaktohet në Kontratën e Pajtimit.

2.3 Nëse kërkonti të shtoni Shërbimin Vodafone TV në llogarinë tuaj ekzistuese të Vodafone, do të lidhni një Kontratë të re me afat minimal siç specifikohet nga Vodafone për të gjitha shërbimet që lidhen me atë llogari që nga data e ndryshimit.

3. Ofrimi i Shërbimit Vodafone TV

3.1 Shërbimet që ne ju ofrojmë sipas kësaj Marrëveshjeje përbëhen nga:

1. Shërbimi Vodafone TV, i cili ofrohet nga ne dhe ju mundëson akses te Përmbajtja/programacioni në televizionin tuaj dhe përfshin Shërbimin Kryesor Vodafone TV;
2. Dekoderin Vodafone TV dhe Pajisjet e Shërbimit Vodafone TV;
3. Përmbajtjen/Programacionin tuaj, që e merrni nëpërmjet Shërbimit Vodafone TV dhe vihet në dispozicion nga ofruesit e shërbimit të përmbajtjeve /programacionit (palë të treta); dhe
4. Aplikacioni Vodafone TV.

3.2 Vodafone përpiqet të ofrojë një shërbim të cilësisë së lartë pa ndërprerje. Megjithatë, Vodafone bën me dije se Shërbimi Vodafone TV mund mos të jetë gjithmonë i aksesueshëm, i vazhdueshëm ose pa defekte dhe se mund të ketë raste kur të gjitha ose disa veçori të tilla si kanalet OTT ose katalogu VOD, mund të mos jenë të disponueshme (qoftë e planifikuar ose e paplanifikuar) ose të modifikohen, pezullohen ose tërhiqen nga ne, sipas gjykimit tonë, pa njoftim. Ju pranoni që Vodafone nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush ose ndaj ndonjë pale të tretë për çdo mungesë, modifikim, pezullim ose tërheqje të ndonjë Përmbajtjeje, ose ndonjë veçorie, pjese ose përmbajtje të Shërbimit TV Vodafone ose dështim për të transmetuar ndonjë program ose kanal televiziv të reklamuar ose për ta bërë këtë në kohën e reklamuar/njoftuar.

3.3 Ne do të bëjmë gjithmonë përpjekjet maksimale për tu siguruar që Shërbimi Vodafone TV të jetë i aksesueshëm nga ju dhe përdoruesit tanë të tjerë dhe do të përpiqemi të ofrojmë një shërbim me cilësi të lartë pa ndërprerje. Megjithatë, ne nuk mund të premtojmë se Shërbimi Vodafone TV do të jetë gjithmonë i aksesueshëm, i vazhdueshëm, i sigurt ose pa defekte apo gabime. Shërbimi juaj Vodafone TV mund të ndikohet dhe/ose të ndërpritet nga rrethana që janë jashtë kontrollit tonë. Për shembull, mund të pësoni ndërprerje për shkak të disponueshmërisë së kanaleve dixhitale në zonën tuaj; kushtet ekstreme të motit; lidhjen tuaj të internetit; dhe disponueshmërinë dhe cilësinë e Përmbajtjes.

3.4 Shërbimi Vodafone TV është për përdorim privat, vendas, jo-tregtar vetëm në banesën tuaj të vetme, private në Republikën e Shqipërisë dhe nuk duhet të përdoret për të transmetuar Përmbajtje në publik ose për qëllime biznesi ose tregtare ose për ndonjë biznes ose ambiente tregtare, përveç nëse është parashikuar ndryshe dhe autorizuar posaçërisht nga Vodafone. Shërbimi Vodafone TV ofrohet vetëm për dekodern Vodafone TV që ndodhet në shtëpinë tuaj rezidenciale dhe ju nuk keni të drejtë të shpërndani ose të transmetoni në ndonjë mënyrë tjetër përmbajtjen e tij në ndonjë pajisje celulare, tablet ose kompjuter personal. Ju nuk keni të drejtë t'i tarifoni (drejtpërsëdrejti ose indirekt) shikuesve një tarifë për shikimin e kanaleve (ose ndonjë prej tyre) ose ndonjë shërbim suplementar dhe/bonus që ne mund të ofrojmë herë pas here dhe në të cilat ju aksesoni përmes Shërbimit Vodafone TV. Në rast se konstatohet se jeni në shkelje të kësaj Klauzole, Vodafone rezervon të drejtën të çaktivizojë, ndryshojë, pezullojë ose ndërpresë ofrimin e Shërbimit me efekt të menjëhershëm. Për më tepër, Vodafone rezervon të drejtën të ngrejë padi civile kundër jush në rastet kur ju jeni në shkelje të kësaj klauzole.

3.5 Ne mund të ndryshojmë herë pas here mënyrën e dorëzimit, formatin dhe përmbajtjen e Shërbimit Vodafone TV. Ju pranoni që përdorimi juaj i Shërbimit Vodafone TV të bëhet mbi bazën “siç është” dhe “siç disponohet” dhe në përgjegjësinë tuaj të vetme.

3.6 Shërbimi Vodafone TV nuk zbaton automatikisht rregullat mbi programacionin e papërshtatshëm për fëmijët (watershed rules). Ju pranoni dhe bini dakord se Vodafone nuk mban asnjë përgjegjësi për të siguruar që aty ku ofrohet një rekomandim për moshën minimale për Përmbajtjen, Përmbajtja të mos shikohet nga persona nën moshën minimale. Ju pranoni dhe bini dakord që prindërit duhet të ushtrojnë kontrollin e tyre prindëror për të siguruar që çdo Përmbajtje e shikuar nga fëmijët e tyre është e përshtatshme.

4. Lidhja juaj në internet dhe kërkesat minimale

4.1 Në mënyrë që ju të aksesoni dhe të merrni shërbimin Vodafone TV, duhet të siguroheni që të keni një shpejtësi minimale fikse të lidhjes në internet prej 8 Mbps të kërkuar për Vodafone TV.



4.2 Për të marrë shërbimin Vodafone TV, duhet të siguroheni që pajisja e Shërbimit Vodafone TV të jetë gjithmonë e lidhur me internetin. Në mënyrë që ju të mund të përdorni plotësisht të gjithë Shërbimin Vodafone TV, ju e kuptoni dhe pranoni se Shërbimi Vodafone TV përdor lidhjen tuaj me brez të gjerë (broadband) për shumë qëllime, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, përditësimet e softuerit, mbledhjen e të dhënave të tipit metadata, vlerësimin se si e përdorni llogarinë tuaj dhe si e aksesoni Përmbajtjen. Në mënyrë që të merrni Shërbimin TV, duhet të na lejoni të aksesojmë detajet e informacionit të llogarisë suaj të klientit, duke përfshirë numrin e referencës së klientit, të cilin e përdorni për marrjen e Shërbimit TV dhe duhet të na lejoni të mbledhim informacione dhe të dhëna nëpërmjet informacionit të llogarisë së klientit dhe pajisjet tuaja, në mënyrë që ne t'ju ofrojmë Shërbimin TV. Aty ku një informacion i tillë përfshin të dhëna personale sipas përkufizimit, Vodafone do të ruajë dhe përpunojë të dhëna të tilla në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si edhe Politikën e Privatësisë të publikuar në linkun: <https://www.vodafone.al/informacion-ligjor/informacion-i-pergjithshem-ligjor/rregullore-e-privatesise/>.

4.3 Nëse nuk keni një lidhje me brez të gjerë Vodafone e cila është të paktën aq e shpejtë sa shpejtësia jonë minimale e detyrueshme, e përshkruar në 4.1 më sipër, ose nëse lidhja juaj me brez të gjerë është ose bëhet e padisponueshme, ndërpritet ose nëse keni kaluar kufijtë e të dhënave me brez të gjerë, ne nuk jemi përgjegjës për asnjë humbje ose dëm që mund të pësoni ose për ndonjë përkeqësim të cilësisë ose aftësisë suaj për të aksesuar dhe përdorur plotësisht Shërbimin Vodafone TV.

5. Pronësia e dekoderit Vodafone TV

5.1 Ju e kuptoni që ne do t'ju ofrojmë Pajisjet e Shërbimit Vodafone TV në mënyrë që të merrni shërbimin. Ju pranoni që të gjitha pajisjet e ofruara nga ne për ju të jenë dhe të mbeten në çdo kohë - pronë ekskluzive e Vodafone. Meqënëse pajisjet do të mbeten gjithmonë pronë ekskluzive e Vodafone, jeni të detyruar që pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, ju t'ia ktheni pajisjen Vodafone.

5.2 Duhet të tregoni të gjithë kujdesin e arsyeshëm me dekoderin Vodafone TV që ju ofrojmë dhe detyroheni ta mbani atë në gjendje të mirë pune gjatë gjithë afatit minimal. Pa cënuar asnjë kusht tjetër në këtë Marrëveshje, ne do të jemi përgjegjës për zëvendësimin ose riparimin e dekoderit Vodafone TV tuaj gjatë periudhës tuaj minimale, me kusht që dëmtimi i dekoderit të mos jetë shkaktuar nga ju. Ne rezervojmë të drejtën për të zëvendësuar çdo dekoder Vodafone TV - të dëmtuar ose të prishur me një dekoder Vodafone TV të ri ose të riparuar.

5.3 Për të marrë Shërbimin duhet të siguroheni që televizori juaj të jetë i lidhur me dekoderin Vodafone TV. Mund të lidhni altoparlantët me dekoderin Vodafone TV, megjithatë nuk duhet të lidhni asnjë pajisje teknologjike tjetër, kompjuter ose lidhje elektronike me pajisjen Vodafone (përfshirë dekoderin Vodafone TV) që mund të dëmtojë ose të shkaktojë ndërhyrje me pajisjen Vodafone. Çdo formë e tillë e ndërhyrjes në Pajisjet Vodafone nga ana juaj do të jetë një shkelje thelbësore e kësaj Marrëveshjeje dhe Vodafone do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm.

5.4 Ju jeni përgjegjës për të siguruar që Pajisja të mbahet gjatë gjithë kohës në mënyrë të sigurt dhe të përdoret siç duhet. Në lidhje me këtë, ju pranoni që nëse Pajisja nuk furnizohet me energji elektrike dhe nuk është e ndezur ose në gjendje gatishmërie, regjistrimet dhe përditësimet nuk do të kryhen gjatë asaj kohe. Ju nuk do të tjetërsoni ose dispononi ndonjë nga Pajisjet në një mënyrë të tillë, si për shembull, të përpiqeni ta shisni atë ose t'ia jepni me qira dikujt tjetër, ose ta vendosni atë si garanci për një hua, hipotekë ose tarifë, ose të lejoni që ndonjë nga Pajisjet të sekuestrohet sipas një procesi ligjor. Ju nuk do ta zhvendosni pajisjen në një vend tjetër pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim.

5.5 Sistemi nPVR (Network Private Video Recorder - Regjistruer Personal Video), ju lejon të regjistroni, planifikoni dhe menaxhoni regjistrimet nga transmetimi linear që mund t'i aksesoni nga dekoderi Vodafone TV ose aplikacioni cellular, për listën e kanaleve OTT

Do të njoftoheni për skadimin e regjistrimit kur të mbeten 10 ditë ose më pak deri në skadimin e përmbajtjes së regjistruar. Në rast të anulimit apo përfundimit të shërbimit TV, nuk do të keni më mundësi të përdorni këto regjistrime.

5.6 Vodafone nuk garanton që funksionimi i dekoderit Vodafone TV do të jetë i pandërprerë ose pa gabime. Aty ku Vodafone konstaton se dekoderi juaj Vodafone TV ka defekt, ne do t'ju japim një dekoder Vodafone TV zëvendësues dhe ju do t'ia ktheni Vodafone dekoderin e dëmtuar.



6. Siguria juaj

6.1 Ju pranoi që jeni në çdo kohë përgjegjës për të siguruar që të dhënat e llogarisë suaj të Shërbimit Vodafone TV të jenë plotësisht të përditësuara.

6.2 Ju pranoi që jeni përgjegjës për ruajtjen e të gjithë emrave të përdoruesve, PIN-ve dhe fjalëkalimeve të sigurta dhe private në çdo kohë dhe kuptoni se në asnjë rrethanë, nuk duhet t'i jepni numrat tuaj PIN, fjalëkalimet ndonjë pale të tretë (përveç nëse dëshironi që ata të përdorin llogarinë tuaj dhe të paguani tarifa shtesë në llogarinë tuaj).

6.3 Ju lutemi na kontaktoni menjëherë duke përdorur detajet në faqen tonë të internetit nëse dyshoni ose viheni në dijeni për ndonjë:

1. shkelje të sigurisë në llogarinë tuaj;
2. ndërhyrje në softuerin e sigurisë në Shërbimin Vodafone TV;
3. përdorim të paautorizuar të Shërbimit Vodafone TV; ose
4. shkelje të tjera ose performancë të dyshimtë në Shërbimin Vodafone TV.

6.4 Nëse dyshojmë ose zbulojmë ndonjë aktivitet të paligjshëm në llogarinë tuaj të Shërbimeve Vodafone TV, duke përfshirë për shembull shmangien e sistemeve të menaxhimit dixhital, atëherë ne mund ta raportojmë aktivitetin në polici dhe do të ndërmarrim çdo veprim tjetër që ne e konsiderojmë të arsyeshëm për të garantuar sigurinë e Shërbimeve Vodafone TV.

7. Informacioni juaj

7.1 Ne mund të përdorim informacionin tuaj në përputhje me këto kushte më poshtë dhe Politikën tonë të Privatësisë, e cila mund të gjendet në linkun: <https://www.vodafone.al/informacion-ligjor/informacion-i-pergjithshem-ligjor/rregullore-e-privatesise/>.

7.2 Ju pranoi se ne mund të përdorim informacionin tuaj për qëllimet e mëposhtme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: menaxhimin e llogarisë tuaj, t'ju ofrojmë shërbimin Vodafone TV që keni kërkuar, të kryejmë aktivitete të kujdesit ndaj klientit dhe të trajnojmë stafin tonë, duke përfshirë monitorimin e thirrjeve, emaileve ose mesazhe me tekst që na dërgoni; monitorojmë cilësinë dhe sigurinë e Shërbimit Vodafone TV, dekoderit Vodafone TV dhe aplikacionit Vodafone TV, rrjetin tonë dhe testojmë dhe mirëmbajmë sistemet tona të IT; Vodafone do të ketë shikueshmëri se si e përdorni Shërbimin Vodafone TV, aplikacionin Vodafone TV dhe dekoderin për qëllime marketingu ose për qëllime të tjera, si p.sh. kryerja e kërkimeve për analiza statistikore. Duke vepruar kështu, ne mund të shqyrtojmë mënyrën se si e përdorni Shërbimin Vodafone TV, si p.sh. zakonet tuaja të shfletimit dhe përdorimit të faqeve tona të internetit. Ne mund të monitorojmë dhe analizojmë se kur dhe sa shpesh ju aksesoni Përmbajtje të caktuara përmes Shërbimit Vodafone TV;

7.3 Kurdoherë që është e mundur, ne do të grumbullojmë ose anonimizojmë informacionin tuaj kur i ndajmë me palët e treta, në mënyrë që të mos jeni të identifikueshëm në asnjë mënyrë. Ne gjithashtu mund të ndajmë informacionin tuaj me ofruesit tanë të shërbimeve të përmbajtjes për t'i ndihmuar ata të analizojnë dhe vlerësojnë shërbimet që ata ofrojnë me ne, ose për çdo qëllim tjetër të identifikuar dhe të përcaktuar në Politikën tonë të Privatësisë dhe për qëllime të hetimeve që kryhen nga ofruesit tanë të shërbimeve të përmbajtjes në shkelje të të drejtave të tyre sipas kësaj Kontrate dhe për qëllime të përdorimit në veprimet e zbatimit të ndërmarra nga ofruesit tanë të shërbimit të përmbajtjes si pasojë e këtyre hetimeve.

8. Ofruesit e përmbajtjes dhe prodhuesit e palëve të treta të Vodafone TV Box

8.1 Në lidhje me ofruesit e Përmbajtjes, ju e kuptoni dhe pranoi që:

1. Vodafone nuk është agjent i ofruesit të përmbajtjes (përveç se në lidhje me faturimin dhe pagesën) dhe Vodafone nuk do të jetë përgjegjës për trajtimin e ndonjë çështjeje në lidhje me shitjen dhe/ose mbështetjen e vazhdueshme të kësaj Përmbajtjeje;
2. ne nuk menaxhojmë ose kontrollojmë ofruesit tanë të përmbajtjes, kështu që nuk mund të planifikojmë ose diktojmë përfshirjen ose kohën e çdo Përmbajtjeje të ofruar si pjesë e Shërbimit Vodafone TV dhe as të mbajmë përgjegjësi për çdo dështim për të shfaqur ndonjë përmbajtje të tillë në Shërbimin Vodafone TV, duke përfshirë një aplikacion i palës së tretë, ku dështimi është jashtë kontrollit të Vodafone; dhe
3. ne nuk mund të garantojmë që çdo informacion i ofruar nga ofruesit e përmbajtjes, ose ndonjë palë tjetër e tretë, është i saktë.



8.2 Përveçse në lidhje me çdo produkt ose pajisje të shërbimit Vodafone TV që ne ofrojmë për klientët tanë, ju pranoi se ne nuk kemi asnjë përgjegjësi mbi asnjë ofrues të përmbajtjes ose kompani prodhuese (palë të treta), kështu që nuk mund të jemi përgjegjës për çdo formë humbjeje ose dëmi të shkaktuar si pasojë e marrëdhënies tuaj me ofruesit e përmbajtjes, prodhuesit ose palët e treta gjatë përdorimit të Shërbimit Vodafone TV.

8.3 Në rast se Përmbajtja në Shërbimin tuaj Vodafone TV ndryshon, ne do të përpiqemi të ofrojmë përmbajtje të ngjashme dhe të përshtatshme zëvendësuese me cilësi dhe vlerë të njëjtë ose të ngjashme sa më shpejt të jetë e mundur dhe do t'ju përditësojmë sipas nevojës. Ju pranoi se ne mund të mos jemi në gjendje t'ju njoftojmë për një ndryshim të tillë.

9. Tarifat dhe pagesa

9.1 Të gjitha tarifat dhe pagesat e tjera të shërbimit Vodafone TV do të paguhen plotësisht nga Klienti brenda datës së pagesës të përcaktuar në faturën e Vodafone. Kur pagesa e Tarifave nuk kryhet brenda datës së caktuar, Vodafone mund të aplikojë një tarifë pagese me vonesë vetëm një herë siç përcaktohet në Listën e Çmimeve. Vodafone rezervon të drejtën të kontaktojë klientin drejtpërdrejt nëpërmjet Shërbimeve me e-mail, me postë ose me telefon në lidhje me pagesat e vonuara.

9.2 Ju pranoi që jeni përgjegjës për çdo tarifë të zbatueshme për përdorimin e Shërbimit Vodafone TV në shtëpinë tuaj, pavarësisht nëse ju ose dikush tjetër (me ose pa lejen tuaj) detyrohet për ato tarifa. Nëse viheni në dijeni për ndonjë përdorim të paautorizuar dhe/ose Shërbimin Vodafone TV nga dikush tjetër, duhet të na njoftoni sa më shpejt që të mundeni. Ju lutemi vini re, nëse nuk na njoftoni për ndonjë përdorim të paautorizuar të Shërbimit Vodafone TV sapo të jeni në dijeni, ne nuk do të jemi përgjegjës për asnjë humbje që mund të pësoni dhe ju mund të jeni përgjegjës për këto tarifa.

10. Mirëmbajtja e Shërbimit Vodafone TV

Ne mund të bëjmë ndryshime në Shërbimin Vodafone TV në çdo kohë për arsye të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në mirëmbajtjen, përmirësimet, rregullimin e gabimeve, përmirësimin e sigorisë dhe/ose si rezultat i kërkesave ligjore ose rregullatore. Këto ndryshime zakonisht do të ndodhin pa ndikuar në aksesin tuaj të Shërbimit Vodafone TV dhe ne do të përpiqemi të sigurojmë që ta bëjmë këtë jashtë orëve të pikut të shikimit, me kohëzgjatje të ndërprerjeve të mbajtura në minimum. Megjithatë, si rezultat i këtyre ndryshimeve, ju mund të humbisni akses në disa ose të gjitha shërbimet tuaja Vodafone TV, por ne do të përpiqemi gjithmonë ta rregullojmë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne nuk do të jemi përgjegjës për çdo humbje të aksesit në Shërbimin Vodafone TV që mund të pësoni nga humbja e përkohshme e aksesit.

11. Kufizimi i Përgjegjësi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

11.1 Ne do të përpiqemi t'ju njoftojmë paraprakisht kur do të pezullojmë ose kufizojmë përdorimin tuaj të Shërbimeve Vodafone TV, por ky njoftim nuk është i detyrueshëm.

11.2 Pa çenuar ndonjë kusht tjetër, ne mund ta zgjidhim këtë Marrëveshje, pjesërisht ose plotësisht, në çdo kohë duke ju shkruar nëse:

1. ju bëni dicka (ose lejoni që të bëhet dicka) që ne mendojmë se mund të dëmtojë ose të ndikojë në funksionimin e rrjetit tonë;
2. një ofrues i përmbajtjes ose një kompani prodhuese (palë e tretë) na informon se ju nuk jeni në përputhje me termat dhe kushtet e tyre;
3. ju nuk bëni diçka thelbësore që duhet të bëni sipas kësaj Marrëveshjeje (për shembull, paguani Tarifat kur duhet) brenda 15 ditëve pasi ne jua kërkojmë me shkrim; ose
4. ne nuk jemi më në gjendje t'ju ofrojmë Shërbimin Vodafone TV ose ndonjë pjesë materiale të Shërbimit Vodafone TV.

11.3 Me përfundimin e Marrëveshjes:

1. ne do të shkëputim pajisjet tuaja dhe çdo dekoder Vodafone TV nga rrjeti ynë dhe nga Shërbimi Vodafone TV;
2. ju do të duhet të paguani të gjitha tarifat që detyroheni në datën që ne shkëputim pajisjet tuaja dhe/ose dekoderin Vodafone TV nga rrjeti ynë dhe Shërbimet Vodafone TV (pas marrjes së një fature).



11.4 Ndonjë herë, por vetëm kur është e nevojshme, Shërbimi Vodafone TV mund të pezullohet ose kushtëzohet. Arsyet mund të jenë teknike, mekanike, operacionale, të lidhura më çështje sigurie informacioni, ligjore ose rregullatore dhe ne do mundohemi të riaktivizojmë shërbimin sa më shpejt të jetë e mundur. Ne nuk do të jemi përgjegjës osë të ngarkohemi më asnjë përgjegjësi për ndonjë pretendim nga ana juaj për ndonjë humbje të mundshme nga ky kufizim shërbimi.

11.5 Lidhur më sa më lart në paragrafin 11.4, në lidhje me arsyet teknike, mekanike, operacionale, të lidhura më çështje sigurie informacioni, ligjore ose rregullatore, ne mund të pezullojmë ose kushtëzojme aksesin në një ose disa pjesë të Shërbimit Vodafone TV nëse ne ose palët e treta, ofrues të shërbimit dhe të përmbajtjes kanë dyshime ose marrin dijeni që dekoderi i Vodafone TV ka ndonjë problem në lidhje me detektimin e të drejtave të menaxhimit dhe të mbrojtjes të të drejtave të pronësisë intelektuale të këtij Shërbimi.

11.6 Ju nuk duhet të përdorni asnjë përmbajtje të shërbimit, brandimit ose të Drejtat Intelektuale të Vodafone dhe/ose palëve të treta, pa një miratim paraprak me shkrim.

12. Të Përgjithshme

Duke lidhur këtë Marrëveshje, ju gjithashtu konfirmoni pëlqimin tuaj për të drejtën e Vodafone për të ndarë informacionin tuaj me ofruesit e shërbimeve (palë të treta) për ofrimin e shërbimit Vodafone TV, në përputhje me klauzolat të paragrafit “Informacioni juaj” dhe Politikën e Privatësisë së Vodafone.

Vodafone Albania Sh.A

Përfaqësuesi i Autorizuar

(_____)

Pajtimtari

(_____)